REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

GJAKOVA

Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 29.10.2026

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.2) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.1) të Rregullores për Prokurim Publik Nr.001/2022, e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr. 002/2024, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës datës 27.10.2026, të parashtruar nga Grupi i Operatorëve Ekonomik N.N.P "VETONI" & "EURO CONSTRUCTION" NNP SHPK., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Rehabilitimi i dyqaneve në Qarshinë e Madhe", Nr. i prokurimit- 632-26-7512-5-2-1, Nr. i brendshëm 632-26-058-521, nxjerr:

V E N D I M

1. REFUZOHET SI E PABAZUAR kërkesa për rishqyrtim e Grupit të Operatorëve Ekonomik N.N.P "VETONI" & "EURO CONSTRUCTION" NNP SHPK., e dt. 27.10.2026, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Rehabilitimi i dyqaneve në Qarshinë e Madhe", Nr. i prokurimit- 632-26-7512-5-2-1, Nr. i brendshëm 632-26-058-521, njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues, të publikuar me datë 22.10.2026 të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.

2. VËRTETOHET njoftimi mbi vendimin e autoritetit kontraktues, i publikuar me datë: 22.10.2026, përmes të cilit është vendosur anulimi i aktivitetit të prokurimit.

3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

A r s y e t i m

Grupi i Operatorëve Ekonomik N.N.P "VETONI" & "EURO CONSTRUCTION" NNP SHPK., me dt.27.10.2026, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Rehabilitimi i dyqaneve në Qarshinë e Madhe", Nr. i prokurimit- 632-26-7512-5-2-1, Nr. i brendshëm 632-26-058-521.

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Gjakovës, më datë 29.10.2026, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe, pas analizimit dhe vlerësimit të pretendimeve të parashtruara, ka konstatuar se:

Pretendimi ankimor i Grupit të Operatorëve Ekonomikë N.N.P. "VETONI" & "EURO CONSTRUCTION" NNP SHPK është i pabazuar, pasi mospërmbushja e kërkesave të Aneksit 8 nuk paraqet thjesht një mangësi formale apo teknike, por lidhet drejtpërdrejt me plotësimin e dokumentit standard të kërkuar nga Autoriteti Kontraktues dhe me informacionet që ky dokument duhet të përmbajë.

Fakti që në Aneksin 8 janë shënuar emrat e dy operatorëve ekonomikë, numrat e biznesit, si dhe janë vendosur nënshkrimet dhe vulat e tyre, nuk nënkupton se formulari është plotësuar në përputhje me të gjitha kërkesat e përcaktuara në të. Përmbushja e një pjese të rubrikave nuk mund të konsiderohet automatikisht si përmbushje e tërësisë së kërkesave të formularit standard.

Në këtë rast, vetë Grupi i Operatorëve Ekonomik ankues pranon se Aneksi 8 nuk është plotësuar në të gjitha rubrikat dhe përpiqet ta kompensojë këtë mangësi duke iu referuar Marrëveshjes së Konsorciumit të dorëzuar si dokument tjetër në ofertë. Mirëpo, dokumentet e ofertës duhet të përmbushin kërkesat konkrete për të cilat janë kërkuar dhe nuk mund të konsiderohet se një dokument tjetër e zëvendëson automatikisht një formular standard të paplotësuar.

Kërkesa për plotësimin e Aneksit 8 ka për qëllim që, në mënyrë të qartë dhe të drejtpërdrejtë, të përcaktohet përbërja e grupit, lideri i grupit, autorizimet dhe përgjegjësitë e anëtarëve, në formën dhe sipas përmbajtjes së përcaktuar nga dokumentacioni standard i prokurimit. Për këtë arsye, nuk mund të pranohet argumenti se çdo mangësi në këtë formular mund të plotësohet duke u referuar në dokumente të tjera të ofertës.

Në këtë drejtim, edhe praktika e prokurimit e trajton Aneksin 8 si dokument të rëndësishëm për përcaktimin e pozitës dhe përgjegjësive të anëtarëve të grupit. Ka raste ku është konstatuar se deklarimi i përgjegjësisë së një anëtari në mënyrë të papajtueshme me kërkesat ligjore nuk mund të konsiderohet thjesht si mangësi formale.

Po ashtu, neni 72 i LPP-së nuk mund të interpretohet si e drejtë e pakufizuar për plotësimin e dokumenteve të ofertës pas afatit të dorëzimit. Sqarimi ose plotësimi lejohet vetëm për informacione ekzistenca e të cilave është e fiksuar para skadimit të afatit dhe që mund të verifikohet objektivisht. Vetë KRPP ka sqaruar se mund të kërkohet sqarim kur dokumentacioni është i paqartë, jo i plotë apo kërkon verifikim, por kjo nuk mund të rezultojë në ndryshimin e kushteve materiale të tenderit apo në krijimin e një deklarimi të ri pas afatit të ofertimit.

Në rastin konkret, kërkesa e Grupit të Operatorëve Ekonomik që informacionet që mungojnë në Aneksin 8 të nxirren nga Marrëveshja e Konsorciumit dhe të konsiderohen sikur janë deklaruar në formularin standard, nuk përbën thjesht sqarim të një paqartësie, por do të kishte efektin e plotësimit të një dokumenti të dorëzuar jo në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit.

Sa i përket referimit në Vendimin e OSHP-së nr. 2026/0523, ky vendim nuk mund të aplikohet në mënyrë automatike në rastin konkret. Çdo çështje duhet të vlerësohet mbi bazën e përmbajtjes konkrete të dokumenteve të ofertës, kërkesave të Dosjes së Tenderit dhe natyrës së mangësisë së konstatuar. Fakti se në një rast tjetër OSHP ka konsideruar një mangësi të caktuar si të sqarueshme nuk krijon rregull të përgjithshëm se çdo mangësi në Aneksin 8 është e sqarueshme dhe nuk mund të çojë në eliminim.

Për më tepër, argumenti i Grupit të Operatorëve Ekonomik se identiteti i liderit dhe i anëtarit mund të identifikohet nga Aneksi 8 nuk e zgjidh çështjen e plotësimit të formularit. Çështja nuk qëndron vetëm në identifikimin e dy operatorëve ekonomikë, por nëse të gjitha deklarimet që kërkohen nga Aneksi 8 janë bërë në mënyrën e përcaktuar dhe nëse informacionet e kërkuara janë deklaruar qartë nga vetë grupi në dokumentin përkatës.

Marrëveshja e Konsorciumit dhe Aneksi 8 kanë funksione të ndryshme në kuadër të ofertës. Marrëveshja e Konsorciumit mund të përcaktojë marrëdhëniet kontraktuale ndërmjet anëtarëve, ndërsa Aneksi 8 përfaqëson deklarimin/formularin standard të kërkuar nga Autoriteti Kontraktues për themelimin e grupit në kuadër të këtij aktiviteti të prokurimit. Prandaj, një dokument tjetër nuk mund të përdoret për të anashkaluar kërkesat e qarta të formularit standard.

Rrjedhimisht, nuk qëndron pretendimi se Autoriteti Kontraktues e ka vlerësuar Aneksin 8 në mënyrë të izoluar. Përkundrazi, dokumentacioni i dorëzuar është shqyrtuar në tërësi, por nga ky shqyrtim është konstatuar se dokumenti specifik i kërkuar për themelimin e grupit nuk është plotësuar në përputhje me kërkesat e Dosjes së Tenderit. Ekzistenca e një marrëveshjeje tjetër në dosjen e ofertës nuk e eliminon këtë mospërputhje.

Në këtë kuptim, nuk kemi të bëjmë me një situatë ku një informacion është vetëm i paqartë dhe kërkon interpretim, por me mungesë/mospërmbushje të deklarimeve të kërkuara në formularin standard. Prandaj, nuk mund të kërkohet që Autoriteti Kontraktues, nëpërmjet nenit 72 të LPP-së, ta plotësojë ose ta korrigjojë pas afatit një dokument të tillë në emër të operatorit ekonomik.

Andaj, duke qenë se Grupi i Operatorëve Ekonomikë nuk e ka plotësuar Aneksin 8 në përputhje me kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe duke qenë se mangësia nuk mund të trajtohet si një sqarim i thjeshtë që nuk prek përmbajtjen e deklarimit, vendimi i Autoritetit Kontraktues për eliminimin e këtij grupi është i bazuar dhe në përputhje me kërkesat e dokumentacionit të tenderit dhe legjislacionit në fuqi.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

Kopje:

Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit te Komunës;
Të gjitha palëve te interesuara;

FATON GUTAJ

Menaxher i Zyrës së Prokurimit

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, pala e paknaqur brenda afatit prej 10 ditëve mund të paraqesë ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP).